



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 26.9.2011, ora 10,30

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Liburn Aliu, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Ministri dhe zyrtarët nga Ministria e MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 20.9.2011,**
3. **Shqyrtimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Tokën Bujqësore me Ministrin e Bujqësisë,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.9.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.9.2011.

3. Shqyrtimi i monitorimit të Ligjit për Tokën Bujqësore me ministrin Blerand Stavileci

Kryetari Nait Hasani falënderoi ministrin për bashkëpunim dhe përgjigje në ftesë të komisionit rreth zbatimit të ligjit për Tokën Bujqësore dhe shkurtimisht njoftoi për problemet që ka hasur GP gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit në fjalë, për çka edhe ministri **Blerand Stavileci** falënderoi dhe shtoi se është njoftuar me punën e këtij komisioni përmes procesverbaleve të dërguara, sidomos lidhur me mbikëqyrjen e këtij ligji. Kryetari **Nait Hasani** shtoi se komunat nuk janë treguar të përgjegjshme sa i përket kësaj pune që ka ndërmarr komisioni përkundrazi kanë dhënë përgjigje të mangëta dhe të pakontrolluara pikërisht për atë arsye se në terren GP ka parë diçka tjetër ndërsa me shkrim ka marr diçka tjetër, e vërteta kryesore është se GP ka vërtetuar shkeljen e rëndë të Ligjit për Tokën Bujqësore nëpër shumë komuna (sidomos në ato të vizituara), derisa përgjigjet kanë qenë më tepër politike e jo faktike. Shkeljet më të rënda, vazhdoi, janë bërë në tokat bujqësore të cilat janë përfshi me komasacion dhe sistem të ujitjes ndaj shfaqti brengën e komisionit se në të ardhmen do të bëhet edhe më keq (në kohën e komunizmit para 20 vitesh toka bujqësore është mbikëqyrë më mirë se sot) dhe kërkoi sugjerime nga ministri për masat që duhet të ndërmarrën sidomos edhe për faktin se komunat nuk ofrojnë të dhëna të duhura për tokat bujqësore.

Ministri **Blerand Stavileci** edhe një herë përshëndeti iniciativën e komisionit për të mbikëqyrë këtë ligj ngase asnjëherë nuk ka pasur më tepër nevojë sesa sot për një gjuhë të përbashkët të institucioneve (ekzekutivi, kuvendi, komunat etj) lidhur me ruajtjen e tokës bujqësore, por edhe të pyjeve shtoi ai, në mënyrë që me një analizë të mirë të ndërmerren hapat konkret. Shumë gjëra që ky komision dhe ekzekutivi po konstaton (të dhënat statistikore) nuk janë të sakta por janë brengosëse p.sh. sa hektar të tokës bujqësore në vit humb Kosova, sepse nuk kemi të dhëna zyrtare, ndaj obligimi i parë për MB parashtrohet sigurimi i këtyre të dhënave për çka komiteti ndërmintoror është angazhuar duke aplikuar tek fondi i IPA lidhur me statistikat bujqësore, me çka do të eliminohet mosqartësimi niveleve të ndryshme, ngase Kosovës që nga viti 1960 i mungojnë statistikat bujqësore. Gjendja momentale është me shumë probleme siç janë uzurpimet, ndërtimet pa leje. Ministria e mjedisit ka kontribuar mjaft në ruajtjen e tokës bujqësore duke mos dhënë leje për tokat e pëlleshme mirëpo kjo nuk ka mjaftuar, ngase ndërrimet e destinimeve megjithatë janë bërë. Për fillim ai shtoi se ky ligj patjetër duhet të harmonizohet me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Planet zhvillimore urbane të komunave por edhe identifikimin e parcelave që prapë lidhet me problemin e sigurimit të të dhënave (projekti AJAX për të cilin është i angazhuar MB). Ai tha se në ministri kanë hasur gjatë vizitave edhe në modele tjera p.sh. sipas një modeli Kroat asnjëherë nuk epet një tokë bujqësore në shfrytëzim nëse 100% nuk është shpenzuar toka urbane. Lajmi i mirë është se obligimi ligjor për stimulime të fermerëve tani e tutje me optimizëm bëhen ngase kërkesat vazhdimisht shtohen nga fermerët. Nëse nuk sigurohet një rrugë e përbashkët institucionale për një ekuilibër të rrugës ligjore, në të ardhmen më vështirë do të eliminohen problemet bujqësore, përfundoi ministri.

Nait Hasani falënderoi dhe ju dha fjalën anëtarëve të komisionit nga të cilët **Rasim Demiri** pyeti a do të ndalen ndërtimet në Prevallë. Ministri tha se pikërisht kjo pyetje lidhet me konstatimin e fundit të tij se vetëm bashkërisht këto gllabërime do të ndalen, për çka është alarmuar Agjencia e pyjeve.

Nijazi Idrizi tha se grupi punues të cilin ai e kryeson, rreth zbatimit të këtij ligji, ka ditur përafërsisht me çfarë sfida do të ballafaqohet, por në terren është has në indiferencë të madhe për tokën bujqësore. Sfidat kryesore kanë qenë : 1. uzurpimet, 2. segmentimet e tokave bujqësore, 3. ndotjet e rënda dhe 4. shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i tyre. Ai përsëriti disa vërejtje që u thanë në këtë takim rreth mosaktivitetit rreth qartësimeve nga komunat, ndaj pyeti ministrin çfarë aktivitete kanë ndërmarr për gjendjen e tokave bujqësore me nivelet përkatëse dhe partnerët e MB-së, mediet etj, a ka plan afatgjatë ministria për mbrojtjen e këtyre tokave, si veprohet me tokat e privatizuara dhe a kontaktohet AKP-ja, a është menduar nga MB për një fond të veçantë për këto toka.

Sevdije Lama pyeti për faktin e mosharmonizimit të të dhënave ku p.sh. në Gjakovë ministria thotë se 6000 ha janë djerrinë ndërsa komuna thotë 640 ha dhe a ka pasur koordinim midis

inspektoratit qendror dhe zyrtarëve komunal, a ka fragmentim të tokës bujqësore të ngastrave më të vogla.

Afërdita Berisha pyeti për mundësin e financimit të projektit për të dhënat statistikore si dhe obligimin e AKP që tokave bujqësore mos ti ndërroj destinimin, a është zvogëluar përqindja e importit e produkteve bujqësore?, a mundet ministria e bujqësisë të krijoj një standard me kriteret e njëjta për të gjitha komunat kur mundet të lejohet ndërrimi i destinacionit të tokës bujqësore për projektet zhvillimore ekonomike p.sh kur projekti mund të punësoj kaç njerëz kaç vlerë kaç milion etj.

Salih Morina u interesua për lëndët në gjykata sa janë ato, sidomos për uzurpime.

Ministri **Blerand Stavileci** filloi nga pyetja e fundit dhe tha se gjatë vitit 2010 janë dërguar 146 lëndë në gjykata ku gjithashtu ai konsideroi se duhet të funksionoj gjuha e përbashkët institucionale ngase këtu involvohet edhe ministria e drejtësisë. Ndërsa sa i përket pyetjes për të dhëna ai tha se bazohen në tri burime: të dhënat e divizioneve brenda departamenteve, entitet statistikor dhe kuvendeve komunale. Mirëpo këto të dhëna nuk janë të sakta, ngase një burim tregon një numër ndërsa burimi tjetër një numër tjetër për të njëjtën çështje. Ky problem do të zgjidhet me iniciativën e cekur më lartë nga MB pasi që është aplikuar në IPA. Në pyetjen e **Afërdita Berishës** sa ka zënë autostrada tokë bujqësore, ministri tha se për këtë autostradë është një komitet i veçantë (**Nait Hasani** sqaroi se deputetja kërkon sqarim se a ka mundur autostrada ti ik tokës bujqësore) dhe se ministria nuk ka mundur të ndërhyjë ngase aty ka edhe faktorë tjerë determinues.

Lidhur me pyetjen e fragmentimit të ngastrave të vogla, ministri tha se ministria harton politika të cilat i ndalojnë ato dhe fokusohen në drejtim të shfrytëzimit të tokave bujqësore që risin sipërfaqen e tokës bujqësore, si pasojë e kësaj vitin e kaluar numri i aplikantëve ka shkuar deri 8000 në sektorin e drithërave, ndërsa në hortikultur ka 13 milion më tepër kërkesa. Lidhur me Gjakovë ministri potencoi se janë planet në ministri dhe fondet dhe gatishmëria për këshilla se ku është më mirë të investohet, me mundësi të riorientimit nëse ka nevojë. Problemi është se MB nuk ka përfaqësuesin në AKP, mirëpo me miratimin e rekomandimeve nga ky komision për këtë ligj, ministria do të angazhohet konkretisht. Lidhur me pyetjet e **Nijazi Idrizit** ministri u fokusua në risit e propozuara në projektligjin për shërbimet këshillimore dhe ligjin për zhvillimin rural të miratuar më parë ku janë paraparë agjencia e pagesave dhe shërbimi këshillimor. Sa i përket komunikimit qendër me komuna vlen neni 8 i Ligjit mirëpo MB do të angazhohet në avancimin e mëtejme për shkak të përgjigjeve sa më të sakta, ngase unioni evropian pikërisht e ka parashtrua këtë kusht për grante : të dhënat statistikore. Ai në fund u përgjigj edhe në pyetjen a ka standard për të ndërhy në një tokë bujqësore, duke thënë se kjo duhet të bëhet vetëm me ligj.

4. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani sugjeroi që komisioni të vendos për rekomandimin për miratim në parim për mbledhjen plenare të projektligjit për Shërbimet Këshillimore, mirëpo pas vërejtjeve financiare nga **Salih Morina** për projektligjet të cilat shkojnë në miratim , kryetari propozoi që në mbledhjen e radhës të vendoset për këtë miratim në parim.

Mbledhja përfundoi në orën 11,45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani